

Sigurime te marines

1. Sigurimi i anijeve

Ofron mbulim per anijet dhe mjetet e tjera lundruese dhe pergjegjesine e riparuesve dhe ndertuesve. Kushtet e Sigurimit te Anijeve percaktohen ne klauzolat e zgjedhura te sigurimit, te cilat perdoren ne tregun nderkombetar te sigurimit te Anijeve, qe ofrohen nga Siguruesi dhe qe percaktohen kryesisht nga destinimi i anijes.

I Siguruari per te lidhur kontrate sigurimi per Anijet duhet te paraqese kerkesen e tij se bashku me:

- Dëshmine e pronesisë ose të interesit tjetër pasuror;
- Dëshmine e flamurit;
- Certifikatat e klases, të vijes së ngarkesës, tonazhit, pajisjeve të sigurimit, radiofonisë dhe radiotelegrafisë, të konstruksionit dhe të lundrimit, të leshuara në përputhje me tipin e anijes.

Demshperblehen demet e shkaktuara si rrjedhoje e humbjes, shpenzimet e kontraktuara qe behen te pagueshme me vertetimin e ngjarjes se sigurimit. Vlera maksimale per t'u demshperblyer eshte ne varesi te shumes se sigurimit dhe klauzoles se zgjedhur dhe percaktuar ne police.

Kontrata e sigurimit i nenshtrohet legjislacionit shqiptar dhe Konventave nderkombetare qe kane te bejne me lundrimin detar dhe te cilat jane te pranuar nga shteti shqiptar.

Tarifat e Sigurimit te Anijeve jane ne funksion te tipit të anijes, moshes se anijes, zones se veprimtarise tregtare, tipit (llojit) te zgjedhur.

Ky lloj sigurimi mbulon humbjet ose demet e objekteve lendore te siguruar shkakuar nga:

- Rreziqet e detrave, lumenjve, liqeneve etj...
- Pirateria, kontakti me mjete transporti tokesor, doku ose pajisje e instalime te portit.
- Termeti, shperthime vullkanike e rrufeja, aksidente ne ngarkim-shkarkim ose levizja e ngarkeses ose e karburantit.

Ne rast te ndodhjes se ndonje demi i Siguruari duhet te njoftoje menjehere sapo te ndodhe ngjarja (sipas formularit te dhene nga Siguruesi), duke njoftuar paraprakisht sapo te ndodhe ngjarja

Sigurimi i mallrave gjate transportit (Cargo)

Ky sigurim mbulon demet fizike të mallrave të shkaktuara nga çdo ngjarje e paparashikuar, e papritur, aksidentale dhe e rastësishme, siç përcaktohet në Klauzolat e Institutit të Londrës, i cili në bazë të një procedure të caktuar ndjek dëmin që mund të ndodhë.

Klauzolat C te Institutit te Mallit - 1/1/1982. Humbjet totale dhe avari te pjesshme ne qofte se shkaktohen nga:

- Zjarri, eksplozioni;
- Aksidente te mjeteve te transportit (perplasje, nxjerrje ne breg, fundosje, nxjerrje ne cektine, permbytje, dalje nga binaret);
- Shpenzimet per shkarkimin e mallit ne nje port te fatkeqesise;
- Kontributi i mallit ne avarine e pergjithshme;
- Humbje ose demtim i mallit per sakrificen gjate avarise se pergjithshme ose hedhje e mallit ne det;
- Shpenzime per shpetimin e ngarkeses.
- Kontributi i mallit ne avarine e pergjithshme;
- Humbje ose demtim i mallit per sakrificen gjate avarise se pergjithshme ose hedhje e mallit ne det;
- Shpenzime per shpetimin e ngarkeses.

Klauzolat B te Institutit te Mallit – 1/1/1982. Si “C” por shtohen:

- Termeti, shperthimi vullkanik, rrufeja;
- Renia e ujit mbi bordin e anijes;
- Renia totale e pakove te vecanta gjate ngarkim-shkarkimit.

Klauzolat A te Institutit te Mallit - 1/1/1982. Nuk emertohen rreziqet, por mbulohen:

Te gjitha demet ose humbjet fizike te shkaktuara nga cfaredo ngjarje e paparishikuar, e papritur, aksidentale dhe e rastesishme.

Keto klauzola jane te njejta me ato te tregut te Londres dhe qe aplikohen pothuajse ne te gjithe Europen. INSIG mbulon te gjitha rreziqet e mundshme qe mund te ndodhin gjate transportit te mallrave, si brenda dhe jashte vendit. Per kete mjafton paraqitja e nje kerkese per sigurim ku te jepen te gjitha te dhenat e hollesishme lidhur me mallin qe do te sigurohet, si dhe pagimi i tarifes se Primit te Sigurimit.